



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 13 korrik 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ramiz Lladrovci, Murselj Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Muhamet Mustafa, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Ali Sadriu.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Mujë Rugova –rektor Universiteti i Prishtinës, Hasan Preteni – Agjencia Kundër Korrupsion.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Arta Demolli - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ramiz Lladrovci – zv.kryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 06.07.2011,
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Agjencisë Kundër Korrupsion, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 06.07.2011,

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 06.07.2011.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Kryesuesi – Opinioni i ZAP-it lidhur me pasqyrat financiare të Universitetit të Prishtinës është i kualifikuar. Vitin e kaluar janë dhënë nëntë rekomandime prej të cilave një nuk është adresuar fare, pesë janë në proces. Shpenzimi i ulët i donacioneve nuk është dashur të përfshihet si e gjetur, sepse kjo nuk varet nga UP-ja. Kërkojmë cilësi më të mirë të informatave. Realizimi i buxhetit - auditorit nuk i janë ofruar të gjitha fletëpagesat, prandaj UP duhet të merr masa lidhur me këtë. Ndryshimi i gjendjes në mes të thesarit dhe njësive akademike duhet të pasqyrohet drejtë. Ngrohja paguhet për metër katrorë dhe ndoshta UP nuk i ka prezantuar auditorit saktë se sa metra katrorë ka UP-ja dhe ka rezultuar me këtë të gjetur. Mungesa e listës së pagave duhet të azhurohet. Vlerësimi i stafit duhet të bëhet çdo vit. Nga Auditori i Përgjithshëm kërkoi që të jap sqarime lidhur me të gjeturën që ka të bëjë me kontratën me Termokos, pastaj me shpenzimin e ulët të donacioneve, të gjeturat e regjistrimit të pronës së paluajtshme. Pa ndërhyrë në pavarësinë e ZAP-it të rishikohet opinioni i raportit pasi që janë disa të gjetura për të cilat ndoshta do të mund të jepej opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes. Hap diskutimin për anëtarët e Komisionit.

Armend Zemaj – Edhe pse Raporti i vitit 2010 për UP-në tregon avancim, megjithatë Universiteti duhet të ketë kujdes më të madh sidomos në fuqizimin e departamentit të financave si dhe në organizimin e brendshëm. Pagesat e bëra si p.sh në kodin mbeturina, janë regjistruar shpenzimet e mëditjeve dhe të telefonit. Kodi tjetër shpenzimet për trajnime, janë regjistruar në kodin dreka zyrtare, rimbushje për paranë e imët, mbyllje e avancit etj. Kërkoi sqarim lidhur me këtë. Është mirë që në të ardhmen Komisioni të ketë një raport të performancës të UP-së. Të gjeturat kanë të bëjnë me departamentin e buxhetit dhe financave, pastaj resurset njerëzore dhe lidhur me këtë kërkoj përgjigje. Komisioni duhet të njoftohet për çdo cent të shpenzuar. Pyeti: a keni pasur këtë pasqyrë dhe pas publikimit të këtij raporti cili është hapi i UP-së në eliminimin e të gjeturave. Në UP obligimet barten nga viti në vit, ndërsa mjetet jo, ky do të jetë problem i madh për Universitetin.

Valbona Dibra – Sipas raportit opinioni është i kualifikuar. Pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale me përjashtim në prezantimin e shpenzimeve për nxehje qendrore. Sipas raportit UP nuk ishte në gjendje të siguroj kontratë për ngrohje me kompaninë Termokos. Shpenzimet e ngrohjes janë shpenzime komunale të cilat nuk kanë nevojë për kontratë. Dhe ZAP-i për këtë çështje ka vendosur për një opinion të kualifikuar. Kërkoj sqarim nga ZAP-i dhe nga përfaqësuesit e UP-së.

Murselj Haljilji – Sipas UP-së ndonjë pasuri është e regjistruar si pronë e komunave. Pyeti: a është kjo kontest pronësor juridik në mes të UP-së dhe komunave apo është kjo një gabim në regjistrimin në kadastër. Çfarë masash janë ndërmarrë për të zgjidhur këto gabime? Dhe nëse dokumentet kanë humbur në UP, atëherë do të duhej të shikohet në kadastër dhe atje do të verifikohet se cila është pasuria e UP-së.

Albert Kinolli – Sipas raportit është shqetësuese moskonfirmimi nëse po paguhen shërbimet që merr UP nga Termokos. Cila është arsyeja për moskonfirmim? Kërkoj sqarim shtesë për pjesën kur thuhet në mungesë të vlerësimit ka rezultuar me mosvazhdimin e kontratës së punës për pagesë të pagës pa kontratë valide. Po ashtu kërkoj sqarim në pjesën që ka të bëjë me subvencione dhe transfere ku thuhet se nga kjo kategori e shpenzimeve janë bërë pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë prej 4622euro. Ky veprim është në kundërshtim me

memorandumin e mirëkuptimit të ministrisë së ekonomisë dhe financave për shpenzimin e të hyrave vetanake, kërkoj sqarim lidhur me këtë. Borxhet- 180mijë e 869euro - UP nuk ka menaxhuar në mënyrë të duhur me fondet financiare dhe është futur në obligime financiare për vitin 2011. Pse ka ndodhë kjo? Sistemi i kontrollit të brendshëm – paraqet dështim sepse UP nuk ka themeluar NJAB dhe nuk ka themeluar Komitetin e Auditimit.

Muhamet Mustafa – Prokurimi në UP është në rregull gjë që është pozitive, mirëpo çështja e pasurisë dhe e auditimit të brendshëm janë shumë të rëndësishme. UP është një prej shpenzuesve më të mëdhenj të buxhetit prandaj kërkohet që të ketë të organizuar shumë mirë auditimin e brendshëm. Prona duhet të jetë e evidentuar në librat e Universitetit dhe të jetë e vlerësuar edhe amoritizmi i saj. Ata që kanë ndërhyrë në pronën e rektoratit, duhet të ndiqen me procedura. Pra përgjegjësia e parë është regjistrimi. Ky problem po përsëritet, sepse në asnjë entitet nuk është e regjistruar mirë prona, kjo është shumë shqetësuese.

Alma Lama – Sipas raportit janë vërejtur gabime në regjistrimin e shpenzimeve duke devijuar si në klasifikimin e tyre ashtu edhe përshkrimin e gabuar të shpenzimit. P.sh tek mbeturinat janë regjistruar shpenzimet e mëditjeve dhe të telefonit, pastaj shërbimet e trajnimit janë regjistruar dreka zyrtare. Kërkoi shpjegim lidhur me këtë. Pse nuk ka shpalosje të duhur të pasurive kapitale? Sipas raportit për kryerjen e punëve të ndryshme, UP ka angazhuar individ të cilët nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune. Kjo është realizuar përmes angazhimit dhe nënshkrimit të kontratave mbi veprën. Dhjet kontrata mbi veprën janë në afat të pacaktuar dhe kontratat e tilla nuk janë në harmoni të plotë me ligjin dhe rregulloret në fuqi. Kërkoj shpjegim lidhur me këtë.

Mujë Rugova –UP ka trajtuar këtë material të ZAP-it dhe krahasuar me vitin paraprak UP është më mirë. Kodi 13230, ka gabime të cilat janë teknike, stafit i është dhënë sugjerime për tejkalimin e parregullsive. Mundësia e UP-së për resurse njerëzore është e kufizuar. Administrata e UP-së është e shpërndarë në pesë objekte dhe kontrolli i stafit është shumë problem. UP-ja është në 5-6 qendra, dhe përpos Prishtinës asnjëra nga këto qendra nuk kanë ngrohje siç është Prishtina. UP-ja nuk ka lidhje të veçantë të ngrohjes. Këtë vit UP është në proces të matjes së hapësirave dhe në këtë mënyrë UP do të dijë se sa metra katrore sipërfaqe ka për ngrohje. Pasuria e UP-së që nga krijimi i universitetit nuk ka qenë e definuar. Të gjitha pasuritë që ka pasur UP-ja, ju janë dhënë ministrive. Jemi në negociata që pasuritë t'i kthehen universitetit. Me rregulloren e re të UP-së, është krijuar një auditor i brendshëm nga tre persona të cilët do të auditojnë UP-në. E keqja me e madhe janë borxhet e trashëguara. Mos pagesa e obligimeve ndaj shtetit nga viti 202 deri në vitin 2006. UP ka 1milion e 600mijë euro borxh komunal. Tani UP ka marrë përsipër që këto borxhe t'i paguaj me rata. Një borxh tjetër prej 700mijë euro po ashtu është i trashëguar nga menaxhmenti i kaluar.

Naser Hyseni –UP – Borxhet – UP ka 22 milion euro buxhet dhe është e pamundur që të kryhen të gjitha pagesat deri në fund të vitit. Çdo blerje kryhet më një procedurë të prokurimit dhe UP ka nënshkruar kontratën por malli ka ardhur mbas datës 22 dhjetor. Këto janë paraqitur në pasqyra financiare. Mos prezantimi në pasqyra financiare i kompanisë “Graniti”. Gjykata ka marrë vendim lidhur me procesin me kompaninë “Graniti” obligimi bie mbi UP që të paguaj. Përkthimet e disa teksteve -120mijë pastaj 400mijë është borxh që pret UP-në, pastaj obligime të tjera që janë kryer në fakultetin Ekonomik, Juridik etj. Pagesat janë duke u bërë në bazë të vendimit të gjykatës. Prandaj edhe shpenzimi i buxhetit nuk është bërë në harmoni me ligjin.

Alma Lama – Pyeti auditorin nëse pas përgjigjeve të përfaqësuesve të universitetit lidhur me ndërrimin e destinacionit të parave kemi të bëjmë me parregullsi apo jo? Mosfunksionimi i mirë i Administratës së UP-së paraqet dështim të menaxhimit. Pyeti: a ka tjetërsim të pronës së Universitetit? Universiteti nuk është institucion i ri dhe do të duhej të dihej se cila është prona e Universitetit. Sipas përfaqësuesit të UP-së Administrata e Universitetit e ka zhytur Universitetin në borxhe dhe nëse qëndron kjo atëherë dikush duhet të jap përgjegjësi.

Mujë Rugova – Ka uzurpim pronash dhe ka toka që janë pronë e Universitetit të cilat ju janë dhënë disa ministrive. Nga këto prona Universiteti mund të gjeneroj të hyra.

Valbona Dibra – Fakti që është dhënë avancë për ngrohje qendrore është dashur të pasqyrohet në raport. Nëse e gjithë vlera 339 mijë euro ka qenë gabim, atëherë e gjetura është materiale. Nuk kontestoi faktet, por e gjetura duhet të jetë më e qartë, sepse krijon konfuzion për opinionin.

Lars Lage OLOFSSON – Raporti thotë se shpenzimet për ngrohjen qendrore nuk janë paraqitur qartë dhe kjo mjafton për auditorin. Pikërisht për vlerën është dhënë opinioni i kualifikuar, sepse ajo është materiale.

Kryesuesi – Propozoi që raporti të mos procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare. Por komisioni ruan të drejtën që pasi të qartësohen shënimet kadastrale të ftohen palët për të sqaruar çështjen e pronësisë së UP-së.

Armend Zemaj – Kuvendi nuk mund të anashkalohet nga raportet. Pas çdo raporti janë nxjerr rekomandime të cilat duhet t'i mbështes dikush politikisht. Nëse dëmtohet pasuria e UP-së, kjo përbën problem politik. Propozoi që raporti të procedohet me rekomandime të Komisionit në mbledhje plenare për shqyrtim.

Valbona Dibra – Tha se raporti gjithëpërfshirës i auditimit procedohet në Kuvend në muajin Gusht, ku janë të përfshira të gjitha raportet e auditimit të ZAP-it. Procedimi i të gjitha raporteve në mbledhje plenare, Kuvendin do të ngarkoj së tepërmi.

Alma Lama - Ishte e mendimit që raportet e auditorit të bëhen bashkë me raportin vjetor të OB-ve dhe të procedohen në mbledhje plenare. Nëse komisioni nxjerr rekomandime si pasojë e raportit atëherë kjo duhet të procedohet për votim. Votimi duhet të bëhet për rekomandim, jo për raport.

Bali Muharremaj - Raportet jo të mira duhet të procedohen në mbledhje plenare, sepse korrupsioni nuk është ndryshe - nëse ka një kontratë në vlerë të madhe.

Albert Kinolli – Tha, në këtë Komision duhet punuar pa pasur për bazë politikën, sepse fjala është për institucionin me interes të përgjithshëm.

Muhamet Mustafa – Ishte i mendimit që kryetari dhe dy zëvendëskryetarët të takohen dhe të marrin vendim se cilat raporte duhet të procedohen në mbledhje plenare për diskutim e cilat jo. Propozoi që komisioni t'i drejtohet Kuvendit me rekomandimin që: *të obligohet Universiteti i Prishtinës dhe Ministria e Arsimit që pasuria publike e Universitetit të evidentohet dhe të pasqyrohet në librat e kontabilitetit të Universitetit. Duhet të iniciohen procedurat e nevojshme që gjithë pasuria e cila në mënyrë të kundërligjshme i është marrë Universitetit të lirohet. Ky rekomandim mund të bëhet së bashku për disa OB.*

Kryesuesi ftoi anëtarët e Komisionit që me ngritje dore të deklarohen për propozimin që raporti të procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike me tre vota “për” dhe tre “kundër” Raporti nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Agjencisë Kundër Korrupsion, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Kryesuesi - Opinioni për këtë raport është opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes. Pyeti: pse nuk është plotësuar numrin i stafit? Agjensioni së bashku me një OB tjetër mund të kenë një

auditorë të brendshëm. Duhet pasur një evidencë të qartë të automjeteve me raporte më të detajuara. Agjensioni ka pasur tender me procedura të kuotimit dhe nuk guxon të pranoj si të përgjegjshëm operatorin ekonomik që e kalon kuotën. Agjensioni ka pasur kuotën nën 10.000 euro dhe ka pranuar mbi 10.000 euro si të përgjegjshme.

Valbona Dibra - Theksimin i çështjes ka të bëjë me shënimin në tabelën 2, ndarjet nga fond i përgjithshëm është prezantuar vlera e buxhetit, që është gabimisht. Kërkoj sqarim lidhur me atë nëse është fjala për gabim teknik ose jo. Rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë zbatuar. Kjo është shumë shqetësuese. Cila është arsyeja e moszbatimit të këtyre rekomandimeve?

Armend Zemaj - Problemi kryesor janë blerjet përmes prokurimit. Nuk po i kushtohet kujdes kuotimit të çmimeve edhe pse ndoshta mund të ketë arsye të veçanta, por ligji duhet të respektohet. Përcjelljes së rekomandimeve duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë. Agjencioni Kundër Korrupsion duhet të jetë më shumë profesional në çështjen e rekrutimit të kandidatëve edhe pse Komisioni nuk ka material shtesë dhe nuk mund ta ketë të qartë se për çka konkretisht bëhet fjalë.

Mursel Haljilji - Pyeti: në faqe 12 nëntitulli certifikata për pagesën e lëndëve të pakompletuara –kërkoj sqarim nga agjencioni se për çka është fjala. Çështja e mirëmbajtjes dhe servisimi i veturave në vlerë prej 2157 euro - është brengosëse që Agjensioni ka shfrytëzuar kontratën e entitetit tjetër, shprehë interesim lidhur me këtë çështje. Në fq 14 të pasurit kapitale dhe jokapitale, - *“regjistri i pasurisë nuk ka qenë gjithherë azhur”* kjo më intereson nuk ka qenë fare azhur apo një shpjegim tjetër për vazhdimin, këtë e kërkoj nga auditori pasi që atje janë zyrtarët që janë të ngarkuar me pasurinë të cilët nuk janë realisht punëtorë të këtij institucioni, kjo është pyetje për agjencionin.

Armend Zemaj – Pyeti: si është nxjerr opinionin me theksim të çështjes, sepse në bazë të gjeturave krahasuar me të gjeturat në entitetet tjera opinionin do të duhej të ishte i pakualifikuar.

Albert Kinolli - Te përzgjedhja e operatorëve ekonomik ne mungesë të tri ofertave të përgjithshme, te certifikimi i pagesave ka të bëjë me furnizimin për material për zyre dhe tek paga dhe medijtë të konkluzionit, te rekrutimi i stafit për kriteret e kërkuara mbi ligjin për shërbyesit civil. Faleminderit .

Hasan Preteni – Buxheti i agjencionit është realizuar me 85% nuk është realizuar pjesa për mallra dhe shërbime që është 78% dhe kjo për arsye se në fillim të vitit bëhen kërkesat dhe në vitin 2009 agjensioni ka kaluar në objekt privat. Me 1 prill pastaj ka kaluar në objekt shtetëror dhe nuk paguan qira. Pjesë tjetër kur është shfrytëzuar buxheti me më pak është 75% te investimet kapitale, agjencioni edhe në aspektin e teknologjisë informative është i pavarur. Rekomandimi dy - përgatitja në dy gjuhë, dëgjimet buxhetore - na është thënë që pasqyrat financiare mund të dorëzohen vetëm në atë gjuhë që janë përgatitur, kjo ka qenë si kërkesë për t`ju ikur shpenzimeve. Blerjet përmes prokurimit - furnizimi me inventar(mobile) dhe çështjen që tre operator kanë qenë të përgjithshëm, problem është fatura e rrymës. Është kërkuar që të gjithë aplikuesit të kenë dëshmi që e kanë paguar rrymën. Nuk ka të bëjë ndonjë shkelje tjetër por vetëm dy aplikues nuk kanë pasur këtë faturë, kurse fituesi e ka pasur dhe kjo është dhënë si vërejtje se duhet të kenë të tretë. Te rasti i dytë ka të bëjmë me kuotim kur tre ofertues të përgjithshëm me të gjitha elementet, por njëri prej tyre ka ofertuar me më shumë se 10.000, i ka plotësuar të gjitha kushtet, por ka konkurrar me më shumë se 10.000. Sipas Ligjit kjo lejohet por, po të kishin të gjithë më shumë se 10.000 nuk na u lejohet. Te certifikimi i pagesave, agjencioni nuk ka dashtë që parandë publike të shpenzoj në investime kapitale duke blerë automjete. Agjensioni ka filluar punën në 2006, atëherë ka pasur zyrat në Kuvend, në ndërtesë ishte edhe Ministria e Transportit e cila mbas 3 muajve të punës së agjencionit i huazon një veturë golf IV të vitit 2001. Janë blerë 3 vetura edhe 2 të huazuara. Kontratat për mirëmbajtje i kanë për të gjitha automjetet i kanë edhe për automjetet që janë në huazim të agjencionit..

Kontrata që ka lidhur Ministria e Transportit me operatorin e ka edhe çmimoren, mirëpo është bërë një intervenim nga 2000 euro, sepse ky automjet e pas një dëmtim në një pjesë e cila pjesë nuk e ka pasur çmimin në çmimore. Rasti i dytë furnizimi për material me zyre, kërkesa për furnizim dhe çmimorja nuk u janë bashkangjitur pagesës edhe pse shuma e paguar ka qenë e paguar sipas çmimores, gabim formal të cilin e pranon Agjensioni.

Kryesuesi - Pyeti: sa është mesatarja e pagës?

Hasan Preteni – Paga e drejtorit është e përcaktuar me Ligj e cila është e njëjtë me pagën e kryetarit të Komisionit në Kuvend, të gjithë zyrtarët tjerë në agjencion e marrin pagën sikur të gjithë shërbyesit civil tjerë me koeficient, por prej 1 prillit të vitit të kaluar të gjithë zyrtarët e agjencionit marrin një shtesë për rrezikshmëri. Në agjencion nuk është i punësuar asnjë zyrtarë që nuk ka përgaditje profesionale, asnjë zyrtarë që vjen nga partitë politike dhe asnjë zyrtarë që ka lidhje familjare me dikend që udhëheqë nëpër institucione. Këtu thotë që është bërë një lëshim, këtë e shoh si një konflikt interesi që auditori nuk është dashur të trajtojë, kam bërë me dije por nuk është marrë në konsideratë sepse janë dhënë disa vërejtje, ku kandidatë për tu pranuar ka qenë vëlla i auditorit që e ka bërë auditimin. Me ligjin për shërbyesit civil nuk është e paraparë, i vetmi gabim formal që është bërë nga agjensioni është se një test të një zyrtarit nuk e ka nënshkruar njëri prej anëtarëve të komisionit. Te menaxhimi i automjeteve – të gjitha shpenzimet janë arsyetuar. Agjensioni nuk ka auditor të brendshëm dhe këtë vit sot do të fillon punën auditori për të audituar punën për 6 mujorin e kaluar.

Lars Lage OLOFSSON - Sa i përket këtij institucioni janë disa gabime të vogla, disa gabime procedurale dhe kryerja e punëve në këtë agjencion konsiderohet e mirë, por sigurisht këto janë çështje të cilat një auditor i brendshëm do të i ndihmonte që t'i kenë parasysh. Auditori i përgjithshëm ka qenë i informuar rreth faktit që udhëheqësi i ekipit të auditimit ishte vllau i njërit prej aplikuesve, dhe kjo është një sfidë sepse ZAP-i mund të gjendet në shumë situatat të tilla. Në raste të tilla auditori informon auditorin e përgjithshëm dhe merr masa për tu siguruar rreth rreth asaj se çka është gjetur dhe rreth asaj çka konkludon.

Vlora Mehmeti – Tha se agjensioni në të tri rastet ka kontraktuar ofertuesit me ofertën me vlerën më të ulët. Pritjet e ZAP-it, për Agjensionin në këtë fushë janë shumë të mëdha përndryshe të gjitha të gjeturat janë jo materiale. Lidhur me rekrutimin e kandidatëve, kandidati i rekrutuar nuk e ka pasur dëshminë në dosje, nuk ka qenë dëshmia lidhur me referencën dhe përvojën e punës. Secili kandidatë duhet të ketë përvojën e punës dhe ndonjë referencë. Pika e dytë është lidhur me rekrutimin e zyrtarit për buxhet dhe financa, është kërkuar që kandidati të ketë njohuri të mira lidhur me buxhetin dhe financat. ZAP ka gjetur se komisioni vlerësues e ka larguar nga lista e ngushtë një nga kandidatet e cila i ka përmbushur këto kritere, personi ka qenë e vjetër në moshë, mirëpo i ka plotësuar të gjitha kriteret tjera. Regjistri i pasurisë nuk ishte azhurnuar vazhdimisht pasi aty figuron një zyrtar i ngarkuar me pasuri që realisht nuk ishin punëtorë në AKK, zyrtarët kanë lëshuar vendin e punës megjithatë ende kanë figuruar në regjistrin e pasurisë, ajo listë duhet me azhurnuar.

Hasan Preteni - Agjensioni në konkurs nuk e ka kërkuar përvojën e punës për pozitën zyrtar që është pozita më e ulët, ndërsa auditori thotë është dashur përvoja e punës.

Lars Lage OLOFSSON - Një nga kriteret është edhe përvoja e punës dhe është e natyrshme që kjo të kërkohej, që kandidati të jetë i aftë të vërtetoj përvojën e punës dhe kjo ishte një nga kriteret me të cilat ka punuar komisioni.

Armend Zemaj- Lidhur me rekrutimin e stafit tha se egziston KPM i cili merret me procedurat e rekrutimit, ankesat etj. dhe kjo e gjetur është rezultat i mosbashkëpunimit të mirë në mes të ZAP dhe Agjencionit. Personalisht është kundër asaj që të kërkohej përvojë pune për zyrtar, sepse ka të rinj që me kualifikime superiore mbesin pa punë si rezultat i këtij kriteri.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

- *Miratohet Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Agjencisë Kundër Korrupsion, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010*
- *Raporti nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.*

5. Të ndryshme

a) Mbikëqyrja e Zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës

Valbona Dibra – Në mbledhjen e fundit që ka pasur Grupi Punues, është kërkuar nga ZAP-i që të dorëzoj raport lidhur me zbatimin e Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës. Deri më sot Grupi Punues nuk ka pranuar raport. Pyeti se kur Grupi punues mund të ketë raportin në mënyrë që të përfundoj detyrën për të cilën është ngarkuar nga Komisioni.

Lars Lage OLOFSSON – Raporti është i gatshëm, por momentalisht është në përkthim. Po ashtu në të njëjtën kohë po shikohet edhe korniza sekondare ligjore që ka të bëjë me Ligjin për shërbimin civil. Deri të hënë grupi punues do ta ketë raportin nga ZAP-i.

b) Lista e ekspertëve

Kryesuesi Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

Në bazë të nenit 4 të Udhëzimit për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve Parlamentare azhurnohet lista aktuale e ekspertëve, si vijon: Jusuf Kryeziu, Ujkan Bajra, Mentor Ramosaj, Artan Venhari, Mustaf Hasani, Albert Krasniqi, Xhevat Meha, Rustem Asllanaj dhe Haki Shatri.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

zv.Kryetar i parë i Komisionit

Ramiz Lladrovci